




REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



ANEKS KONTRATË

Numri i aneks kontratës:¹ 626-23-7568-5-3-5/C142

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të Sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me nr. të biznesit: 810842668 selia në Prishtinë; "ARHIKO. ING" O.P. me nr. të biznesit: 811274084 selia në Prishtinë dhe N.N.SH. "ARDI" me nr. të biznesit 811152834 selia në Malishevë, të cilët në bazë të marrëveshjes së grupit i përfaqëson z. Arlind Buzhala në cilësinë e Drejtorit të O.E. AAB CONSTRUCTION SH.P.K. , (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një aneks kontratë publike për punë shtesë të shënuara më poshtë:

Titulli i Tenderit: NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAHÇELIK - ASKER-Punët shtesë 626-23-7568-5-3-5 dhe nr. të brendshëm 626-23-017-5-3-5

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës ka të bëjë me kryerjen e punëve shtesë për ndërtimin e kanalizimit fekale përgjatë rrugës Bahcelik-Asker në Mamushë, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj aneks kontrate, sipas pozicioneve të punëve shtesë të cilat janë aprovuar nga Menaxheri i Kontratës, Kryetari i Komunës dhe për të cilat është njoftuar edhe KRPP në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 neni 35.1. për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Punët do të kryhen brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve.

Në emër të kësaj aneks kontrate Operatori Ekonomik do ti kryej punët si në vijim:

PARAMASA DHE PARALLOGARIA NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAHÇELIK - ASKER - Punë shtesë			
I. Lidhja në mes veti e kanalizimeve ekzistuese			
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

1	Demolimi me kujdes I kubezave anash rruges. Pas perfundimit te kanalit dhe shtresave te zhavorrit te behet vendosja e kubezave te njejta. Verejtje: mbetet ne pergjegjesine e pune kryesit ti demoloj me kujdes kubezat dhe te i ruaj, pasi qe nese mungojne kubezat gjate montimit, furnizimin me kubeza te reja duhet ta beje pune kryesi	m ²	260.00
2	Gërmimi i kanalit për kolektorin kryesor në kat. (II-IV) më makinë në gjërësi sipas (varësisht nga diametri i gypit) normave dhe standardeve.	m ³	475.00
3	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës ne largesi deri në 5km.	m ³	475.00
4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në trashesi 10cm ne fundin e kanalit anash dhe trashesi 10 cm mbi tub dhe ngjeshja në shtresa	m ³	92.00
5	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion (16-32)mm për mbushjën e kanalit nga pjesa e sipërme të gypit deri ne nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m ³	320.00
II. Vazhdim i kanalizimit ekzistues			
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia
1	Gërmimi i kanalit për kolektorin kryesor, dhe kanalin e ujmbledhsave, në dheun e kat. (II-IV) më makinë në gjërësi sipas (varësisht nga diametri i gypit) normave dhe standardeve.	m ³	375.00
2	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës ne largesi deri në 5km.	m ³	375.00
3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në trashesi 10cm ne fundin e kanalit anash dhe trashesi 10 cm mbi tub dhe ngjeshja në shtresa	m ³	95.00
4	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion (16-32)mm për mbushjën e kanalit nga pjesa e sipërme të gypit deri ne nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m ³	320.00

Neni 2

Kjo aneks Kontratë lidhet në mes palëve kontraktuese duke u mbështetur në nenin 35 Paragrafi 2.4 pika (ii) të LPP-s si dhe në kontratën e datës **20.04.2023** e lidhur ndërmjet Komunës së Mamushës si Autoritet Kontraktues dhe Grupit të Operatorëve Ekonomik **AAB CONSTRUCTION SH.P.K. "ARHIKO. ING" O.P. dhe N.N.SH. "ARDI"** të cilët në bazë të marrëveshjes së grupit i përfaqëson z. Arlind Buzhala në cilësinë e Drejtorit të O.E. **AAB CONSTRUCTION SH.P.K.** për projektin me titull: **"NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAHÇELIK - ASKER"**. Palët nënshkruese të kontratës pajtohen që të nënshkruajnë këtë aneks Kontratë, për vazhdimin e punëve shtesë të cilat kanë dalë si pasojë e mos parashikimit të sasisë të kërkuar në kontratën bazë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i furnizimeve do të jetë, gjithsejtë: **5,763.00 €;**

Pesëmijë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e tre Euro.

3.2 Çmimi i punëve është dhënë në ofertën financiare të kontraktuesit. Çmimi total i kontratës është dhënë në euro.

3.3 Çmimi që i referohet paragrafit 3.1 me lartë do të jete e vetmja pagesë që e ka borxh autoriteti kontraktues ndaj kontraktuesit sipas aneks kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe nuk mund të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e Veçanta të kontratës bazë.

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën, konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë në kontratë të datës **20.04.2023**.

Neni 4 Komunikimet

Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë aneks kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit, dhe duhet të dërgohen me postë, faks, e-mail: ose të dorëzohen personalisht sipas kontratës bazë të parapara në Kushtet e Veçanta.

Neni 5 Sigurimi i ekzekutimit


Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% apo **576.30 EUR** për periudhën prej **dyzetë (40)** ditëve.

Neni 6


E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Neni 7

Të gjitha nenet tjera të kontratës mbeten në fuqi dhe do të zbatohen sipas kushteve dhe ligjit të cekur në kontratë të datës 20.04.2023 me numër të prokurimit 626-23-1290-5-2-1 dhe titull: “NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAHÇELIK - ASKER”

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Gazmend Gashi	Emri:	Arlind Buzhala
Pozita:	Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10.08.2023	Data:	10.08.2023
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAÇELIK - ASKER - Punë shtesë					
I. Lidhja në mes veti e kanalizimeve ekzistuese					
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Demolimi me kujdes I kubezave anash rruges. Pas perfundimit te kanalit dhe shtresave te zhavorit te behet vendosja e kubezave te njejta. Verejtje: mbetet ne pergjegjesine e punekryesit ti demoloj me kujdes kubezat dhe te i ruaj, pasiqe nese mungojne kubezat gjate montimit, furnizimin me kubeza te reja duhet ta beje punekryesi	m²	260.00	4.00	1,040.00 €
2	Gërmimi i kanalit për kolektorin kryesor në kat. (II-IV) më makinë në gjërësi sipas (varësisht nga diametri i gypit) normave dhe standardeve.	m³	475.00	0.70	332.50 €
3	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës ne largesi deri në 5km.	m³	475.00	0.50	237.50 €
4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në trashesi 10cm ne fundin e kanalit anash dhe trashesi 10 cm mbi tub dhe ngjeshja në shtresa	m³	92.00	4.00	368.00 €
5	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion (16-32)mm për mbushjën e kanalit nga pjesa e sipërme të gypit deri ne nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m³	320.00	3.00	960.00 €
Gjithsej					2,938.00 €
II. Vazhdim i kanalizimit ekzistues					
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Gërmimi i kanalit për kolektorin kryesor, dhe kanalin e ujmbledhsave, në dheun e kat. (II-IV) më makinë në gjërësi sipas (varësisht nga diametri i gypit) normave dhe standardeve.	m³	375.00	1.00	375.00 €
2	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës ne largesi deri në 5km.	m³	375.00	1.00	375.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në trashesi 10cm ne fundin e kanalit anash dhe trashesi 10 cm mbi tub dhe ngjeshja në shtresa	m³	95.00	5.00	475.00 €
4	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion (16-32)mm për mbushjën e kanalit nga pjesa e sipërme të gypit deri ne nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m³	320.00	5.00	1,600.00 €
Gjithsej					2,825.00 €
REKAPITULLIMI					
I	Lidhja në mes veti e kanalizimeve ekzistuese				2,938.00 €
II	Vazhdim i kanalizimit ekzistues				2,825.00 €
Totali:					5,763.00 €





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **116312**

Për **Komuna e Mamushes**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAHQELIK - ASKER" -PUNË SHITESË**

Nr. prokurimit: 626-23-7568-5-3-5 , Nr. brendshëm: 626-23-017-5-2-1/5

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **576.30€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **576.30€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 40 ditë kalendarike prej **10.08.2023** deri më **19.09.2023**

Data lëshimit: 10.08.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **116312**

Kontraktuesi	
Emri	AAB CONSTRUCTION SH.P.K.
Përfaqësuar nga	Arind Buzhala
Adresa	Prishtinë, Luan Haradinaj Sol 1 Hy.1 nr.4
Nr i Biznesit	810842668
Telefoni	044302293
Përfituesi	
Emri	Komuna e Mamushes
Adresa	Mamushe
Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka	NLB
Garantuesit	
Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguar	576.30
Periudha Sigurimit	10.08.2023 - 19.09.2023
Primi	20.00
Tvsh	3.60
Primi Bruto	23.60
Data e lëshimit	10.08.2023 12:57
Aktiviteti Ekonomik: NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËT BAHQELIK - ASKER" -PUNË SHITESË	

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesi/Garantuesi).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Leudona Balaj - 2569



Përfaqësuesi i të sigurvearit
Arind Buzhala